



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Mujor – Tetor 2007

Vendimet e paarsyetuara mbi paraburgim shkelin ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

OSBE më parë ka shprehur shqetësimet e veta për arsyetimet joadekuate në vendimet me anë të të cilave urdhërohet paraburgimi.¹ Megjithatë, OSBE nënvizon se në shumicën e rasteve të monitoruara, gjykatat e Kosovës akoma dështojnë në arsyetimin e duhur të vendimeve mbi paraburgim.

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kërkojnë nga gjykatat që ato të japin arsye për vendimet e tyre.² Vendimi i arsyetuar duhet t'i bazojë në ligj faktet e rastit, dhe nuk duhet të jetë “i përgjithësuar dhe abstrakt”.³ Arsyetimi i duhur i një vendimi mbi paraburgim është i domosdoshëm në mënyrë që të pandehurit ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të sfiduar ligjshmërinë e paraburgimit përmes ankesës⁴ ose petitionit *habeas corpus*.⁵

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës (“Kodi i Procedurës Penale”) parasheh që, kur të vendos mbi paraburgim,⁶ gjykata të jap “një sqarim të të gjitha fakteve materiale të cilat përcaktuan paraburgimin përfshirë këtu edhe arsytet mbi dyshimin e bazuar se personi ka kryer veprën penale si dhe *faktet materiale* të parapara me Nenin 281 [...]”.⁷ Gjyqtari gjithashtu duhet të ofroj arsye mbi atë se përse masat alternative kundrejt paraburgimit nuk janë të mjaftueshme.⁸

Përkundër këtyre kërkesave të qarta, OSBE ka vërejtur se në shumicën e rasteve të monitoruara gjykatat ende nuk i referohen fakteve të rastit, duke dështuar kështu të japin sqarim mbi atë se si rrethanat e veçanta autorizojnë privimin e të dyshuarit nga liria.

Në një rast pranë një gjykate të qarkut, më 16 mars 2007 gjyqtari i procedurës paraprake caktoi paraburgim për një muaj ndaj një të pandehuri të dyshuar për

¹ Shih p.sh. raportet e OSBE-së *Shqyrtimi e Sistemit të Drejtësisë Penale (prill 2003 – tetor 2004): Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi*, (tetor 2004) fq. 32; dhe *Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale (1999 – 2005): Reforma dhe Shqetësimet e Mbetura* (mars 2006), fq. 52.

² Shih p.sh., Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Smirnova v. Rusia*, 24 tetor 2003, par. 65 ff. Aty, Gjykata gjeti se paraburgimi i aplikuesit gjatë hetimeve dërgoi në shkeljen e Nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi që vendimet e lëshuara nga gjykata ishin “të përmbledhura” dhe nuk “përkrauanin në detaje karakteristikat e situatës së aplikuesit” (par.70-71).

³ Id., Par. 63.

⁴ Shih Nenin 283(3), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i miratuar përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003.

⁵ Shih Neni 286(2) dhe (3) të Kodit të Procedurës Penale (procedura “*habeas corpus*”). Paraburgimi është i kundërligjshëm, përpos kur është vendosur “në përputhje me procedurën e përkrauar me ligj” (shih Nenin 5(1)(c), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenin 9(1), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike).

⁶ Në përmbledhje, paraburgimi mund të urdhërohet vetëm nëse njëkohësisht plotësohen kushtet në vijim të parapara me Nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale: (1) dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale; (2) rreziku se i pandehuri mund (a) të fshihet; ose (b) ndikoj në dëshmitarë ose të shkatërrorë dëshmitë; ose (c) të përsërisë veprën penale; (3) pamjaftueshmëria e ndonjë mase tjetër më të lehtë të paraparë me Nenin 268 të Kodit të Procedurës Penale.

⁷ Shih Nenin 283(1), Kodi i Procedurës Penale (theksi i shtuar).

⁸ Shih Neni 281(1)(3), Kodi i Procedurës Penale. Më tej, sipas Qarkores së Drejtësisë 2000/27 të 19 dhjetorit 2000, të gjitha vendimet mbi paraburgim duhet të jenë të bazuara në një vendim me shkrim plotësisht të arsyetuar duke dhënë detaje për bazat për paraburgim dhe dëshmi mbi të cilat është mbështetur në përkrahje të këtyre bazave.

vrasje,⁹ me arsyetimin siç vijon: “*propozimi i prokurorit për të vendosur paraburgimin është i ligjshëm dhe bazohet në dëshmi. Baza ligjore, pika (ii) është arsyetuar në mënyrë të duhur përderisa pikës së parë ligjore (i) i mungon arsyetimi. Gjyqtari i procedurës paraprake duke vepruar në përputhje me nenin 268 (2) të [Kodit të Procedurës Penale të Kosovës], erdhi te përfundimi se në rastin konkret nuk mund të aplikohet asnjë masë tjetër alternative përpos masës së paraburgimit.*”

Në një rast pranë një gjykate komunale, që përfshinte procedurën paraprake kundër katër të pandehurve të dyshuar për mashtrim, falsifikim të dokumenteve dhe legalizim të përmbajtjes së pavërtetë,¹⁰ më 20 tetor 2006 gjykata urdhëroi një muaj paraburgim me arsyetimin siç vijon: “*në bazë të shkresave të lëndës ekziston dyshimi i bazuar se të dyshuarit kanë kryer veprat penale me të cilat ata ngarkohen. Sa i përket kushteve nga pika (i) nënparagrafi 2 dhe 1 të nenit 281 të [Kodit të Procedurës Penale të Kosovës], gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se ka bazë. Respektivisht, duke pasur parasysh se të dyshuarit kanë kryer veprat penale të cilat paraqesin rrezik për shoqërinë dhe mënyrën e kryerjes së atyre veprave, gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se po që se lihen në liri apo në qoftë së ndonjë masë tjetër alternative caktohet kundër tyre, ekziston frika që ata të vihen në arrati. Gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se nuk mund të sigurohet prezenca e të dyshuarve duke caktuar ndonjë masë tjetër alternative përpos masës së paraburgimit.*”

Në një rast pranë një gjykate komunale, më 30 prill 2007 gjyqtari i procedurës paraprake caktoi një muaj paraburgim kundër një të pandehuri të dyshuar për marrje ryshfeti¹¹ “*sepse po të gjinden në liri, ekziston rreziku që [ai] mund të pengoi rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, palët e dëmtuara ose bashkë-kryesit. Duke pasur parasysh seriozitetin e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat ajo është kryer, veçoritë dhe rrethanat tjera personale, ekziston rreziku që ata të përsërisin veprën penale.*”

Në rastet e lartpërmendura, gjykatat dështuan t’i referohen fakteve të rastit dhe e kufizuan veten në parafrazim të ligjit (në disa raste konfuze). Kështu, ato dështuan të tregojnë se arsyet për paraburgim siç kërkohet nga neni 281 të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë në atë rast të veçantë. Arsyetimi i pamjaftueshëm ose mos arsyetimi i vendimit shkel standardet për gjykim të drejtë¹² dhe mbase edhe të drejtën për liri,¹³ dhe rrjedhimisht duhet të ketë ankesë për vendimin me të cilin caktohet paraburgimi.

⁹ Neni 146, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i miratuar përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003 (Kodi Penal).

¹⁰ Neni 332, 261 dhe 334, Kodi Penal.

¹¹ Neni 343 (1), Kodi Penal.

¹² Shih Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *García v. Spanjës*, 30544/96, i datës 21 janar 1999, paragrafi 26.

¹³ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Yagci dhe Sargin v. Turqisë*, 9 qershor 1995, paragrafi 52 rreziku i ikjes si bazë e vetme për paraburgim nuk mund të vendoset vetëm mbi bazë të seriozitetit të dënimit të kërcënuar, por duhet të vlerësohet me referim në një numër faktorësh tjerë); *Tomasi v. Francës*, aktgjykimi, 27 gusht 1992, paragraf 98 (gjykata duhet të sqarojë rrezikun e ikjes dhe pse ky rrezik nuk mund të parandalohet me masë tjetër alternative kundrejt paraburgimit); dhe *Clooth v. Belgjikës*, 12718/87, aktgjykimi, 12 dhjetor 1991, paragrafi 40 (rreziku i kriminalitetit të vazhdueshëm duhet të jetë i besueshëm dhe masa e duhur duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe në veçanti historinë dhe personalitetin e personit për të cilin bëhet fjalë).

Për atë që u tha më lartë, OSBE përkujton avokatët dhe gjyqësinë se:

- Gjykatat duhet të japin arsye adekuate kur marrin vendime që kanë të bëjnë me paraburgim.
- Në veçanti, gjykatat duhet të citojnë dëshmitë relevante dhe rrethanat faktike individuale të rastit si dhe të sqarojnë se pse masat alternative kundrejt paraburgimit nuk janë të përshtatshme.
- Avokatët duhet të parashtrojnë ankesa kundër vendimeve të paarsyetuara siç parashihet me Nenin 286 (3)(2) ose Nenin 283(3) të Kodit të Kosovës të Procedurës Penale.

Dështimi në përpilimin e procesverbaleve të sakta dhe të plota në procedurën civile përbën shkelje të ligjit vendor

OSBE është e shqetësuar lidhur me dështimin e vërejtur të gjykatave në mbajtjen e procesverbaleve të sakta dhe të plota në gjykimet civile.

Ligji mbi Procedurën Kontestimore¹⁴ thotë se procesverbalet duhet të përpilohen [...] “për të gjitha veprimet e ndërmarra në seancat gjyqësore.”¹⁵ Duhet të regjistrohet nga gjykatat: “emërtimi dhe përbërja e gjykatës, vendi ku ushtrohet veprimi, dita dhe ora kur ushtrohet veprimi, emërtimi i objektit të kontestit dhe emrat e palëve të pranishme ose të personave të tretë dhe të përfaqësuesve e të autorizuesve të tyre ligjorë.”¹⁶ Për më tepër, “[n]ë procesverbal mbi seancën kryesore duhet përfshirë sidomos: se a ka qenë seanca publike apo e mbyllur për publik, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre dhe provat e ofruara, provat e propozuara së bashku me citate nga deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëshmitarëve ekspertë, si dhe vendimet e gjykatës që janë marrë në seancë.”¹⁷

Përkundër këtyre dispozitave ligjore, OSBE ka vërejtur se gjykatat në Kosovë shpesh dështojnë në mbajtjen e procesverbaleve të sakta dhe të plota gjyqësore. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

Në përmbarimin e një vendimi pranë një gjykate komunale, ku paditësi kishte fituar kompensimin për dëm, i padituri nuk ishte paraqitur në procedurën përmbarimore më 18 korrik 2007. Megjithatë, procesverbali i gjykatës thotë se ndalesa për shitje ose hedhje poshtë në çfarëdo mënyre e pronës së luajtshme i ishte sqaruar të paditurit.

Në një rast pranë një gjykate komunale, procesverbali i shqyrtimit kryesor të mbajtur më 2 korrik 2007, përfshinte emrat e gjyqtarëve porotë të cilët nuk ishin prezent.

¹⁴ Ligji mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 27/90 dhe 35/91.

¹⁵ Neni 123, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁶ Neni 124, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁷ Id.

Në një kontest pronësor pranë një gjykate komunale, gjyqtari urdhëroi përfaqësuesin e palës së paditur të ia parashtrij gjykatës certifikatën e vdekjes të të paditurit të tretë. Procesverbali gjyqësor i 5 shtatorit 2007 dështoi të reflektojë këtë urdhër. Për më tepër, dy orë të ndryshme janë shënuar si fillim i seancës.

Në një rast pranë një gjykate komunale që përfshinte një kontest familjar, gjykata dështoi të regjistrojë se a kanë qenë publike seancat për shqyrtim kryesor të mbajtura më 20 gusht 2007 dhe 3 shtator 2007. Procesverbali gjithashtu nuk përmbante informacion lidhur me atë se a e kishte verifikuar gjyqtari identitetin e palëve.

Dështimi i gjykatave të Kosovës për të mbajtur procesverbale të plota dhe të sakta në këto raste përbën shkelje të ligjit vendor. Veç kësaj, në qoftë se procesverbalet gjyqësore janë të pasakta, pala mund të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive të parashtrijë ankesë për shkak të shkeljeve procedurale dhe mbase kështu nuk lihet mundësia për mjete ligjore lidhur me shkelje të ligjit vendor dhe standardeve për gjykim të drejtë.¹⁸ Për më shumë, dështimi sistematik i gjykatave në mbajtjen e procesverbaleve të sakta dhe të plota pengon zhvillimin e një gjyqësie efektive, të përgjegjshme dhe transparente në Kosovë.

Për atë që u tha më lartë, OSBE rekomandon:

- Gjyqtarët duhet të sigurojnë që të gjitha procesverbalet e procedurave gjyqësore të përmbajnë informacione të sakta dhe të plota.

¹⁸ Siç është e garantuar e Nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.